



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:254183

Datë: 05.12.2023

Numri i dokumentit: 05015924

**P.nr.5/2023**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K nga Prishtina, rruga “...” nr..., i akuzuar për vepër penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, të parashikuar nga neni 358 par.5. lidhur me par.2. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.4843/2021, datë.28.12.2022, të cilin sipas autorizimit e mbronë Avokat Arbër Osmanaj nga Prishtina, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me datë 04.12.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Arianit Salihu, të autorizuarit të dëmtuarit, sipas autorizimit Avokat Halim Kuliqi, të dëmtuarit I.Zh, mbrojtësit të akuzuarit dhe të akuzuarit, me datë 04.12.2023, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me **datë 05.12.2023** përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: F.K**, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur me dt... në Prishtinë, ku edhe tani e ka vendbanimin rruga “...” nr..., me numër personal të letërnjoftimit ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijve, një prej tyre i mitur, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i N.T.T “...”, me seli në Parkun e Biznesit në Korroticë të Epërme, Komuna e Drenasit, i gjendjës së mirë ekonomike, më parë i pagjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale.

### Ë S H T Ë F A J T O R

**SEPSE:** i akuzuari F.K, si pronar-person përgjegjës i Kompanisë N.T.T “...”, me seli në Parkun e Biznesit në Korroticë të Epërme, Komuna e Drenasit, në kundërshtim me nenet 6 paragrafi 1, nenit 7 paragrafët 1,2,3,4,8,9 dhe 10, nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, të nenit 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. të Ligjit mbi sigurinë dhe shëndetin në punë dhe shtojcës 1 paragrafi 7 të Rregullores së MPMS Nr.-06-2017 për ndërmarrjen e masave për shmangien e rreziqeve, si detyrim i përgjithshëm i punëdhënësit dhe shkelje të dispozitës së nenit 11 paragrafi 1.3 të Ligjit

të Punës, duke mos marrë masa për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës, në pajtim me rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës, duke rrezikuar jetën e njerëzve, ashtu që me datë 26.06.2021, derisa punëtori-i dëmtuari I.Zh, kishte qenë i angazhuar në prodhim, në një moment kur ishte bllokuar paisja-makineria e punës duke hedhur ngjitës, dhe derisa i dëmtuari kishte bërë përpjekje përmes një shkopi për zhbllokimin e makinerisë, për të e tërhequr ngjitësin nga cilindri i makinës, i dëmtuari I.Zh, sipas akt ekspertimit mjeko-ligjor në bazë të dokumentacionit, i përpiluar me datë 18.12.2022, nga ana e ekspertës mjeko ligjore Dr.Bergita Curri, kishte pësuar dëmtim të rëndë trupor, me pasojë të përherëshme, në formë të këputjes të plotë të parakrahut të majtë, e cila është shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë të mprehtë,-

**-me këtë ka kryer vepër penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigorisë në vendin e punës, të parashikuar nga neni 358 par.5. lidhur me par.2. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj gjykata në vështrim të neneve 4,7,17,23,38,42,43,44,69 dhe nenit 358 par.5. lidhur me par.2. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 359,360,364, 449 par.2.6. lidhur me par.3 dhe 452. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i:

## CAKTON

**DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE** prej 6 (gjashtë) muaj.

Në bazë të nenit 44 par.1. të KPRK-së, pasi që gjykata ka caktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i akuzuari ka dhënë pëlqimin që dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Në bazë të nenit 44 të KPRK-së, gjykata i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

**Të akuzuarit F.K në shumë prej 2.000 (dymijë) €**, të cilin do të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditë.**

Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siq parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të akuzuarit, në vend të shqiptimit të dënimit me burg, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) Euro gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **20 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **70 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbartimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbartimit me dhunë.

I dëmtuari I.Zh nga ..., rruga "...", Komuna e Drenasit, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, nuk ka ushtruar kërkesë.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.4843/2021, datë 28.12.2022, ka akuzuar të akuzuarin për vepër penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, të parashikuar nga neni 358 par.5. lidhur me par.2. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 04.12.2023, ku ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Arianit Salihu, i autorizuari i të dëmtuarit, sipas autorizimit Avokat Halim Kuliqi, i dëmtuari I.Zh, mbrojtësit i të akuzuarit dhe të akuzuari.

I dëmtuari ishte njoftuar me të drejtat e përcaktuar në bazë të nenit 63 të KPP-së.

Në bazë të nenit 318 par.2. të KPP-së, gjyqtari e ka pyetur të dëmtuarin se a ka paraqitur kërkesën pasurore juridike. I dëmtuara ka deklaruar se jo. Gjyqtari e ka udhëzuar të dëmtuarin, se mund të paraqesë propozim për realizimin e kësaj kërkesë në procedurën penale.

I autorizuari i të dëmtuarit, Avokat Halim Kuliqi, ka deklaruar, se: lidhur me kompensimin e dëmit, gjykatën e njoftojmë se me datën 01.12.2023, kemi lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore, e cila është lidhur në mes të dëmtuarit I.Zh dhe të akuzuarit F.K, lidhur me kompensimin e dëmit, për format siç vijon: për frikën, për dhimbjen fizike, për shëmtim trupor, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për ndihmë dhe kujdes të huaj, për ushqim të përforcuar, për rehabilitim fizioterapeutik si dhe për shpenzimet e protezës së dorës. Nga kjo rezulton, se i akuzuari 50 % të shumës, që jemi pajtuar me këtë marrëveshje, e ka paguar me rastin e lidhjes së kësaj marrëveshje, ndërsa shumën tjetër mbetet të e paguaj në afatin brenda 6 (gjashtë) muaj, ashtu që, me nga një kopje të kësaj marrëveshje, e pajisim gjykatën dhe prokurorin, ndërsa pala e akuzuar ka kopjen e vet të marrur nga noteri.

I dëmtuari I.Zh, ka deklaruar se: pajtohem mnë tërësi me deklarin e të autorizuarit tim.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija, ashtu siç e parashehë neni 319 par.1. dhe par.2. të KPP-së. I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet për të drejtat e tija.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar me leximin e aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4843/2021, datë 28.12.2022, nga Prokurori i Shtetit Arianit Salihu, duke përjashtura pjesët e aktakuzës të specifikuar në par.3. të nenit 237 të KPP-së, ashtu siç e parashehë neni 320 të KPP-së.

Në bazë të nenit 321 par.1. të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se i akuzuari e kupton aktakuzën, të akuzuarit ia ka dhënë mundësinë që të pranoj ose të mos e pranoj fajësinë.

Në bazë të nenit 321 par.1. të KPP-së, i akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi, për të gjitha pikat e aktakuzës dhe gjyqtari në bazë të nenit 242 par.2. të KPP-së, ka përcaktuar se: 1.- i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; -2.- pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin

mbrojtës dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, përveç premtimeve të cekura në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 230 të këtij Kodi; -3.- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, siç është dëshmia e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori i shtetit; dhe 4.- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në bazë të nenit 322 par. 2. të KPP-së, në shqyrtimin e pranimin të fajësisë së të akuzuarit, gjyqtari ka dëgjuar mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të të akuzuarit dhe palës së dëmtuar..

Të njëjtit deklaruan se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 322 par.4. të KPP-së, gjyqtari ka vlerësuar se kërkesat nga neni 242 par.2. të KPP-së janë përmbushur, dhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Arianit Salihu, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pranimi i fajësisë është bërë në bazë të nenit 242 par.2. të KPP-së dhe është në përputhshmëri me provat në të cilat është mbështetur aktakuza. Me këtë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës dhe se i njëjti është kryes i veprës penale me të cilën ngarkohet. I propozojmë gjykatës që të njëjtin të e shpall fajtor dhe e dënoi sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, si rrethanë lehtësuese të marr pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit. Si rrethana rënduese të merr parasysh pasojat e veprës penale respektivisht dëmtimin e rëndë trupor që ditën kritike e ka pësuar i dëmtuari.

I autorizuari i të dëmtuarit, Avokat Halim Kuliqi, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë, paraqiti sinqeritet para gjykatës si dhe ka paraqitur gatishmëri për kompenzimin e dëmit, për format e lartëcekura i propozoi gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit, të ketë parasysh vetëm rrethanat lehtësuese për të akuzuarin. Lidhur me kompenzimin e dëmit të shkaktuar, me këtë vepër penale për format në të cilat figurojnë në marrëveshje, konsiderojmë se ky detyrim i të akuzuarit është përmbushur dhe për pjesën tjetër, do të përmbushet në të ardhmën nga i akuzuari, nuk kërkojmë kompenzim dëmi, gjegjësisht nuk parashtrijmë kërkesë pasurore juridike në procedurë penale.

I dëmtuari I.Zh, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: pajtohem në tërësi me të deklarimin e të autorizuarit tim.

Mbrojtësi i të akuzuarit Avokat Arbër Osmanaj, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: i propozojmë gjykatës që me rastin e caktimit të sanksionit penal, të merr parasysh rrethanat lehtësuese, që gjenden të i akuzuari, dhe atë: duke filluar me sjelljen e të akuzuarit që në momentet e ndodhjes së aksidentit në punë, ku i akuzuari ka qenë ai që ka shkuar të ndihmoi të dëmtuarin, duke e dërguar të mjeku, e poashtu ndihmën financiare që ia ka ofruar të dëmtuarit që prej ndodhjes së aksidentit, e deri në arritjen e marrëveshjes, i cili fakt është konstatuar nga palët në nenin 9 të marrëveshjes për kompenzim të dëmit, që deri në arritje të marrëveshjes nga pagesat e vazhdueshme, i kishte paguar total 8000 €, krejt kjo jashtë shumës së marrëveshjes. Të marr parasysh, që i akuzuari dhe i dëmtuari kanë arrit marrëveshjen jashtëgjyqësore për kompenzimin e dëmit, ashtu siq deklaroi përfaqësuesi i palës së dëmtuar, e që ka përmbushur detyrimin e pjesë së pare, ka paguar 27.000 €, që nënkupton se i akuzuari ka restituar dëmet, për aq sa janë të mundshme. Poashtu, të ketë parasysh edhe karakterin e mirë të akuzuarit, që përveç tjerash, argumentohet nga fakti se më anë të marrëveshjes, i akuzuari është zotuar dhe ka marr detyrim për të iu ofruar edhe punësim të përshatshëm dhe në afat të pacaktuar të dëmtuarit, në varësi, se i dëmtuari a dëshiron të punoi të i akuzuari. E poashtu, gjykata të merr parasysh rrethanë veçanërisht lehtësuese, pranimin e fajësisë, nuk ka të kaluar kriminale, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale dhe më parë nuk ka qenë i gjykuar, se është mbajtës i familjes, është baba i tre fëmijëve, një prej tyre i mitur dhe tjetri në studime. Nga këto, konsideroi se qëllimi i dënimit do

të arrihej edhe me shqiptim të dënimit me kusht apo eventualisht po që se gjykata, do të shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të ia zëvendësonte me dënim me gjobë. Dhe nga sjelljet e të akuzuarit pas rastit, kuptohet se i akuzuari ka shprehur keqardhjen e tij dhe kërkim faljen për rastin e ndodhur.

I akuzuari F.K, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështesë në tërësi fjalën e mbrojtësit tim, e kam pranuar fajësinë, gjykatës i premtoi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohem për veprën e kryer penale, edhe tani i kërkoj falje të madhe të dëmtuarit, shprehi keqardhje të madhe, shumë tjetër të pagesës do të ia paguaj ashtu siq është marrëveshja, mund të ndodh edhe më herët dhe betohem se pagesën tjetër do të ia kryej pa asnjë problem, i kam premtuar I., se mund të vazhdoi të punoi në firmën time, poashtu edhe bashkëshortja e tij, kjo varet nga vullneti i tyre, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke i vlersuar me ndergjegje provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në bazë të nenit 7 par.1. dhe nenit 360 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe nga provat dhe faktet që i përmbanë aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, të parashikuar nga neni 358 par.5. lidhur me par.2. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me pakujdesi të vetëdijshme, pasi qe ishte i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit të tij, por me mendjelehtësi ka menduar se ajo nuk do të shkaktohet apo se ky do të mundë të e parandalojë shkaktimin e saj.

I akuzuari e ka kryer këtë veprë penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, të parashikuar nga neni 358 par.5. lidhur me par.2. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse në bazë të nenit 7 të KPRK-së, kjo veprë penale është veprë e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si veprë penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë veprë penale është shpallur fajtor, sepse në përputhje me nenin 17 par.1. të KPRK-së thuhet se “kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”. Në rastin konkret i akuzuari këtë veprë penale e ka kryer me pakujdesi të vetëdijshme sipas nenit 23 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin, pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, gjykatës i premtoi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohet për veprën e kryer penale, i kërkon falje të madhe të dëmtuarit, shpreh keqardhje, i martuar, mbajtës i familjës, kryefamiljarë, i martuar, baba i tre fëmijëve, një prej tyre i mitur, sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së kësaj vepre penale, ndihmë e dhënë të dëmtuarit, duke e dërguar të mjeku, ndihmën financiare që ia ka ofruar të dëmtuarit që prej ndodhjes së aksidentit, e deri në arritjen e marrëveshjes, i cili fakt është konstatuar nga palët në nenin 9 të marrëveshjes për kompenzim të dëmit, që deri në arritje të marrëveshjes nga pagesat e vazhdueshme, i kishte paguar gjithsej 8.000 €, krejt kjo jashtë shumës së marrëveshjes, si dhe se me datën 01.12.2023, është lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore, në mes të dëmtuarit I.Zh dhe të akuzuarit F.K,

lidhur me kompenzimin e demit, për format siç vijon: për frikën, për dhimbjen fizike, për shëmtim trupor, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për ndihmë dhe kujdes të huaj, për ushqim të përforcuar, për rehabilitim fizioterapeutik si dhe për shpenzimet e protezës së dorës, ku nga kjo rezulton, se i akuzuari 50 % të shumës, që janë pajtuar me këtë marrëveshje, e ka paguar me rastin e lidhjes së kësaj marrëveshje, ndërsa shumën tjetër mbetet të e paguaj në afatin brenda 6 (gjashtë) muaj, ndërsa rrethana rënduese gjeti se shkalla e demit të shkaktuar të i dëmtuari është shumë e lartë, i cili pësuar dëmtim të rëndë trupor, me pasojë të përherëshme, në formë të këputjes të plotë të parakrahut të majtë. Andaj edhe pse për këtë veprë penale është i paraparë dënimi me burg deri në pesë (5) vite, të njëjtit ia caktoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, pasi që gjykata ka caktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, në bazë të nenit 44 par.1. të KPRK-së, i akuzuari ka dhënë pëlqimin që dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të i zëvendësohet me dënim me gjobë, dhe gjykata njëkohësisht vendosi që dënimi me burg të zëvendësohet me dënim me gjobë, dhe i shqiptoi dënim me gjobë të akuzuarit në shumë prej 2.000 (dymijë) € (nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqind ditë, kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së), ku gjykata pati parasysht nenin 44 par.2. të KPRK, ku është përcaktuar se “kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, gjykata nuk kufizohet me shkallën e përlllogaritjes të përcaktuar në nenin 43 par.3. të KPRK-së”. Me bindjen se dënimi me gjobë është në përputhshmeri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të të akuzuarit, dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e bazoi në nenin 450 par.1. nenit 452 par.1. lidhur me nenin 449 par.2. nënpar.2.1. të KPP-së, ashtu që e detyroi të akuzuarin që të paguaj shumën prej 20 € në emër të shpenzimeve të mjekësisë ligjore.

Vendimin që i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 70 €, gjykata e bazoi në nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së. duke pasur parasysht zgjatjen dhe ndërlikueshmerinë e procedurës dhe gjendjen financiare të të akuzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet euro (20) €.

I dëmtuari I.Zh nga ..., rruga "...", Komuna e Drenasit, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike lidhur me kompenzimin e demit të shkaktuar me këtë veprë penale, nuk ka ushtruar kërkesë.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.5/2023, datë 05.12.2023**

**Procesmbajtësja**  
**Elheme Kastrati**

**Gj y q t a r i**  
**Shfqet Baleci**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, personat e autorizuar (të paraparë sipas nenit 381 par.1. të KPP-së), kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (e paraparë sipas nenit 374 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së), në afat prej tredhjetë (30) ditëve (e paraparë sipas nenit 380 par.1. të KPP-së), duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit (e paraparë në bazë të nenit 380 par.3. të KPP-së).